



Datë: 16.06.2025  
Numër Protokolli: 5333/2025

A.nr. 813/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A. nr. 813/2025, të datës 05.05.2025, të parashtruar nga ankuesi A.H, në çështjen juridike – administrative “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të datës 16.06.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I.Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A. Nr. 813/2025, e datës 05.05.2025, e parashtruar nga ankuesi A.H

**II.Mbetet** në fuqi Vendimi i datës 05.03.2025 ( pa numër dhe vulë protokolli), i Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës.

## A r s y e t i m

Ankuesi A.H (*tutje referuar ankuesi*), më datë 05.05.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 05.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, më të cilin ankuesi është shpallur përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore “braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune”, duke aplikuar masën disiplinore “largimin nga shërbimi civil”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 19.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.05.2025, i ka përcjellë shkresat e bashkëngjitura të lëndës, duke mos dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 2954/2025 të datës 05.05.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e datës 05.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës; Vendimin e datës 31.07.2024 për transferimin e ankuesit; Akt Emërimit AE Nr.01-112-1068 të datës 08.01.2024; Raportin e një shkeljeje disiplinore të supozuar, të datës 03.02.2025; Emailin e datës 04.04.2025 për dërgimin e vendimit; Kopjen e ID-së së ankuesit;

Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.05.2025; Përgjigjen në ankesë, të datës 21.05.2025; Vendimin A. Nr.1152/2024 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Procesverbalin e datës 05.03.2025 dhe 10.02.2025 të Komisionit Disiplinor; Ftesën për seancë e datës 04.05.2025; Ftesën për seancë të komisionit disiplinor e datës 07.02.2025 për ankuesin; Emailin e datës 10.02.2025 të ankuesit për pjesëmarrje në seancën disiplinore; Deklaratën e datës 10.20.2025; Njoftimin e datës 05.02.2025 për iniciimin e procedurës disiplinore për ankuesin; Emailin e datës 27.01.2025 nga F.F për F.A, E.P, V.A, F.D; Emailin e datës 10.12.2024 nga F.F për F.A; Emailin e datës 15.01.2024 nga F.A për F.F, N.K dhe F.M; Emailin e datës 15.10.2024 nga F.F për N.K, F.M, F.A; Emailin e datës 10.12.2024 nga ankuesit për F.F.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç, dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesi sipas Aktit të Emërimit AE. Nr.01-112-1068 të datës 08.01.2024, ishte emëruar në pozitën e punës *Zyrtar për Leje Ndërtimore*, në Drejtorinë e Urbanizimit në Komunën e Prishtinës. Tutje, sipas shkresave të lëndës, rezulton së ankuesi me Vendimin me numër 14-112/02-99352/24 të datës 31.07.2024, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ishte transferuar në mënyrë të përkohshme në pozitën Zyrtar për Ndërtimtari në kuadër të Drejtorisë së Transformimeve, gjegjësisht për periudhën kohore prej 01.08.2024 deri më datë 31.07.2025, vendim të cilin ankuesi e kishte kontestuar me ankesë në Këshill, po që Këshilli të njëjtin vendim e kishte lenë në fuqi - sipas Vendimit A. Nr.1152/2024, të datës 27.09.2024, duke e konsideruar si transferim në interes të institucionit.

Me tej, më datë 03.02.2025, Drejtori i Drejtorisë së Transformimit ka paraqitur raporti për iniciim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit, më pretendimin së i njëjti në pozitën e zyrtarit të ndërtimtarisë, ka bërë shkelje disiplinore “*mungesë e paarsyeshme dhe të vazhdueshme nga puna më shumë se tre muaj*”, sipas nenit 56 paragrafi 4 pika 4.10 sipas Rregullores Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civilë.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, me Vendimin e datës 05.03.2025 (pa numër dhe vulë), e ka shpall ankuesin përgjegjës për shkelje të rëndë disiplinore të përcaktuar me nenin 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.10 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore “*Largim nga Shërbimi Civil*”.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e kundërshton Vendimin e datës 05.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës, [të pranuar sipas thënieve në ankesë më datë 04.04.2025], duke pretenduar së ky akt është nxjerr jashtë afatit prej 30 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës në Komisionin Disiplinor dhe nuk ka pasur asnjë shtyrje të këtij afati. **Kërkon** që ankesa të aprovohet dhe të kthehet në vendin e punës me të gjitha obligimet nga dita e largimit nga shërbimi civil dhe të largohet masa disiplinore nga dosja personale.

Kolegji i Këshillit për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me çështjen ankimore, iu referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: “*Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo*

*kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

*- Neni 56, paragrafi 1 dhe 4: “Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhenca e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civilë; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”.- Neni 57 paragrafi 2: “Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunësve/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

*-Neni 58, paragrafit 2 :“Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.*

Po ashtu, Kolegji analizoi edhe bazën ligjore në fuqi, që e rregullon çështjen e vijueshmërisë në punë të nëpunësve civil, gjegjësisht Rregulloren (QRK) - Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë, e aplikueshme nga data 28.02.2024, ku e njëjta përcakton se: Neni 16 [Respektimi i orarit të punës] *Gjatë orarit të punës zyrtari publik është i obliguar të jetë prezent në vendin e punës.... Neni 17 [Evidenca e vijueshmërisë në punë ]1. Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë. 2. Vijueshmëria në punë e zyrtarit publik evidentohet përmes regjistrimit në sistemin elektronik që administrohet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. 3. Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues. 4. Evidentimi i vijueshmërisë në punë sipas paragrafit 1 të këtij neni realizohet përmes pajisjeve elektronike të vendosura në hyrje të secilit institucion publik që mundësojnë hyrjen dhe daljen nga objekti dhe regjistrojnë çdo hyrje-dalje të zyrtarit. 5. Mungesa e evidentimit të vijueshmërisë në punë nga zyrtari llogaritet si mungesë në punë. Neni 18 [Regjistrimi i vijueshmërisë përmes sistemit elektronik] 1. Sistemi elektronik i vijueshmërisë në punë siguron regjistrimin e hyrje – daljeve të zyrtarëve publikë në hapësirat zyrtare të institucionit, duke ofruar mundësinë e regjistrimit të ardhjes në punë, përfundimit të orarit të punës, daljeve zyrtare, daljes dhe kthimit nga*

*pushimi gjatë orarit si dhe daljeve me leje të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë. 2. Regjistrimi i hyrjeve dhe daljeve përfshin orën e saktë të hyrjes dhe daljes. 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”*

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, Kolegji ka analizuar aktin e goditur më ankesë në ndërlidhje edhe më provat materiale të çështjes, nga konstatoi së Komisioni Disiplinor i Komunës së Prishtinës, në procedurë lidhur me çështjen disiplinore të ankuesit ka vërtetuar drejtë përgjegjësinë disiplinore të ankuesit, duke argumentuar saktë gjendjen faktike dhe duke shqiptuar masë disiplinore në raport të drejtë më shkeljen e konstatuar. Rrjedhimisht, bazuar në analizimin e provave të lëndës rrjedhë së ankuesi Vendimin e Këshillit A. Nr. 1152/2024, të datës 27.09.2024, e ka pranuar më datë 05.10.2024, dhe se i njëjti që nga kjo datë e deri më datën kur edhe është iniciuar procedura disiplinore ndaj tij, datë 03.02.2025, nuk është paraqitur në punë dhe si njëjti as pranë Komisionit Disiplinor dhe as në procedurë ankimore nuk ka ofruar dëshmi që e arsyetojnë mungesën e paautorizuar në punë, si prova për pushim vjetor apo pushim për shkaqe shëndetësore, veprime-mos veprime këto të ankuesit që bien ndesh më Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publikë.

Gjegjësisht, sipas deklaratave të ankuesit të dhëna pranë Komisionit Disiplinor, mungesat në punë i ka pohuar edhe vetë ankuesi (në seancën dëgjimore pranë Komisionit Disiplinor të datës 10.02.2025), ku i njëjti në pyetjen e pashtuar nga kryetarit deklaroi së: Pyetje: **Prej cilës datë ju nuk jeni lajmëruar në punë?** - ankuesi është përgjigjur: *Unë në punë nuk jom lajmëru nëse nuk gaboј kah fundi i shtatorit...hala pa e marr vendimin nga Këshilli për transfer, përgjigjen në ankesë që e kam pas në këshill për transfer unë hala pa e marr prej tynve unë vete kam pas filluar pushimin mjekësor, nëse nuk gaboј 28 shtator ka qenë kur kam fillu nëse nuk gaboј, nuk jam i sigurt, Pyetje: **Vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës që është refuzuar ankesë kundër transferimit është më datë 27.09.2023 nuk e di në cilën datë e ke pranu?** - Ankuesi përgjigjet: *unë e kam pranuar më 05 tetor 2024...me 05 tetor se një javë më vonë ka ardh, edhe në momentin që e kam pranu menjëherë kam njoftu përmes emailit shefin F.F. Me të thënë të drejtën nuk e kam ditë as kan e kam shef edhe ju kam drejtu edhe F edhe B. Të dy ju kam drejtu për ma sigurt edhe në email ju kam sqaru më komplet arsyen pse jam në pushim mjekësor, mirëpo ju kam tregu që raportin mjekësor nuk muj me dorëzu në burimet njerëzore të diskrecionit të terapisë edhe të diagnozës, ndërsa shenjat i dorëzoј në momentin kur mbyllet pushimi.**

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit, bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës ka gjetur së ankuesi kishte njoftuar Udhëheqësin e Sektorit për Menaxhimin e Kontratave të Ndërtimeve të Larta, së i njëjti për shkak të gjendjes shëndetësore gjendet në pushim mjekësor, mirëpo ankuesi asnjëherë nuk ishte paraqitur në punë pranë njësisë ku ishte transferuar, dhe po ashtu ankuesi nuk kishte bërë kërkesë për pushim mjekësor, sipas procedurës apo të ketë prezantuar dëshmi mjekësore lidhur me gjendjen shëndetësore dhe rekomandimin e mjekut për pushim mjekësor.

Lidhur me pretendimin ankimor së Vendimi i datës 05.03.2025, i Komisionit Disiplinor i Komunës së Prishtinës është nxjerr jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, Kolegji nga provat materiale konstaton së ky pretendim nuk ka mbështetje sepse kërkesa për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit është përcjell pranë Komisionit Disiplinor me datë 04.02.2025, ndërsa, vendimi i kontestuar është nxjerrë më datë 05.03.2025, pra vendimi është nxjerrë brenda afatit të përcaktuar me nenin 13 paragrafi 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil.

Në kuptim të së drejtës ligjore të palës ankues në mbrojtje aktive, Kolegji ka vërtetuar së ankuesi ishte njoftuar më shkaqet për të cilat ishte iniciuar procedura disiplinore ndaj tij, i është dhënë mundësia e deklaramit dhe ofrimit të fakteve dhe provave, të drejta këto tw garantuar me nenin 13, paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ku thuhet se: “4. *Procedura administrative disiplinore garanton të drejtën e nëpunësit për t’u njoftuar lidhur me fillimin e procedurës, për t’u informuar lidhur me shkeljen faktike të pretenduar dhe provat për kryerjen e saj, të drejtën për t’u dëgjuar, për të paraqitur prova, të drejtën për të pasur qasje në dokumente që lidhen me procedurën, për mbrojtje juridike, të drejtën për t’u asistuar, si dhe të drejtën për t’u ankuar ndaj vendimit përfundimtar*”.

Andaj, bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: “**Neni 88 1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. Neni 89** Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ”, Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë erdhi në vlerësimin së në veprimet dhe mos veprimet e ankuesit manifestohen të gjitha elementet e shkeljes së rëndë disiplinore “**braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune**, dhe së masa disiplinore është në proporcion me shkeljen e ndodhur, andaj, mbi këto rrethana rezulton së akti i kundërshtuar me ankesë është akt i ligjshëm dhe i nxjerr mbi gjendje të fakteve të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë si dhe me zbatim të drejtë të ligjit material.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e la në fuqi si të ligjshëm Vendimin e datës 05.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Prishtinës.

**Këshillë juridike:** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
***Lënda: A.nr. 813/2025***

**Avdyl BEKTESHI**

**Procesmbajtës**

**Ardita Haxhnikaj DEMI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- *Ankuesit A.H;*
- *Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*